



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008,” e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022 shuma prej 917,179.21€ të barten për shfrytëzim në vitin fiskal 2023

Neni 1

1.1 Komuna e Suharekës gjatë vitit 2022 ka tejkaluar planin buxhetor të të hyrave vetanake për pjesën e inkasimit të denimeve nga gjukatat, trafikut dhe pujeve në shumë prej **182,779.44€**.

1.2 Në vitin 2022, të hyrat vetanake kanë qenë të planifikuara, **2,054,989€**, ndërsa gjatë tërë vitit fiskal 2022, janë grumbulluar gjithsej shuma prej **2,237,768.44€**.

1.3 Mjetet e grumbulluara si tepriçë prej **182,779.44€** dhe shuma e pa shpenzuar që duhet bartur në vitin fiskal 2023 prej **734,399.77€** e si total i bartjes është shuma prej **(182,779.44€ +(plus) 734,399.44€)=917,179.21€**, shuma në fjalë duhet të bartet në programin SIMFK-së, dhe të lejohet për alokim, në këto programe dhe kategori ekonomike.

Tabela 1.

Programet/nënprogramet	Mallra dhe Sherbime	Shpenzimet Komunale	Subvencione dhe Transfere	Invstime Kapitale	TOTAL:
Administrata (16312)	9,931.02		-		9,931.02
Sherbimet Publike dhe Emergjente (18012)	-	5,542.00		881,264.22	886,806.22
Planifikim e Urbaniz. (66365)	5,109.36				5,109.36
Administra e Shëndetësis (73021)	-		100.00		100.00
Shëndeti primar-QKMF (73750)	-			5,000.00	5,000.00
Kultur Rini e Sport (85012)	-		1,071.00		1,071.00
Adminstrata- Arsimit (92060)		9,161.61			9,161.61
TOTAL:	15,040.38	14,703.61	1,171.00	886,264.22	917,179.21

Tabela 2.

Nr.	EMRI I PROJEKTIT	Bartja 2022
	Sherbimet Publike dhe emergjente-Infrastrukturë rrugore:	881,264.22
1	50659 Ndertimi dhe rregullimi i varrezave në qytet - Suharekë	179,000.00
2	52397 Ndërtimi i rrugëve lokale segmenti i rrugës “Skënderbeu”, “Aleksander Moisiu” - segmenti i rrugës “Bajarm Curri” –segment në Suharekë	150,000.00
3	52014 Ndertimi i rrugeve: "Regjep Velia"- me segment, "Molika", "Shaljanet"- segment, "Kovaqi ", "Tafa", "Jetush Shala", "Haxhi Shania", etj ne Mushtisht.	20,000.00
4	52023 Ndertimi dhe rregullimi i Kolektorit ne rrugen "Skenderbeu"- Suharekë	153,989.44
5	52514 Instalimi dhe sanimi i ndriqimeve publike në Nishor, Budakovë, Dellocë Maqitëvë	148,774.78
6	52373 Ndertimi i rrugës Peqan i Vogël-Semetisht .	10,000.00
7	52364 Ndertimi i rrugëve lokale"BUNARI I LIMANIT" DHE "FEHMI MORINA"- Vazhdim në SAMADRAXHE	101,500.00
8	52533 Ndertimi dhe sanimi I rrugëve lokale "SOPIJE-VRANIQ" DHE "REQAN-BUKOSH"	118,000.00
	Shërbimi i Kujdesit Primar (QKMF) :	5,000.00
1	50507 Blerja e paisjeve dhe montimi i sistemit të menaxhimit të radhës QKMF	5,000.00
	TOTALI :	886,264.22

Neni 2

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtijë vendim i njeiti do të shërbej për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake të mbetura pa u shfrytëzuar nga viti 2021 dhe viti 2022, e të cilat do të barten dhe shpenzohen në vitin fiskal 2023.

Neni 4

Me hyrjen ne fuqi të këtijë vendimi shfuqizohet vendimi me numer të protokollit 01-Nr-016-47549 i datës 28.07.2023.

KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI